



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Shprehje interesi “Tryeza e Diskutimit Statistikat”

Instituti i Statistikave, INSTAT është institucioni i cili mbulon fushën e Statistikave Zyrtare.

Kapitulli 18 “Statistikat”, është pjesë e kapitujve themelorë të grupit të parë (cluster) të cilat sipas metodologjisë së re të Komisionit Evropian, do të shqyrtohen të parët.

Në kuadrin e veprimtarive për integrimin evropian, INSTAT është institucioni përgjegjës për përputhshmërinë e akteve komunitare të parashikuara në Kapitullin 18 “Statistikat”, në bashkëpunim me agjensitë statistikore Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave.

Aktet komunitare (acquis communautaire) në fushën e statistikave përbëhen nga legjislacioni i cili është direkt i zbatueshëm në Shtetet Anëtare të KE, siç janë Rregulloret e Parlamentit Evropian, Rregulloret e Këshillit Evropian, Vendimet e tyre dhe Rregulloret e Komisionit Evropian. Aktet komunitare mbi statistikën përmbajnë gjithashtu një gamë të gjerë të udhëzuesve metodologjikë në fusha të ndryshme statistikore si politikat ekonomike dhe monetare, statistikën demografike dhe sociale, statistikën sektoriale si Bujqësia, Energjia, Transporti, Turizmi, etj, si dhe inovacioni apo teknologjia e informacionit. Standardet ndërkombëtare si parimet themelore të statistikave dhe kodi i praktikave të statistikave evropiane ofrojnë parimet bazë mbi të cilat duhet të mbështetet prodhimi dhe përhapja e statistikave zyrtare.

Mbështetur në VKM nr. 749, datë 19.12.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse, për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian” si dhe në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit të RSH, nr.113, datë 30.08.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të platformës së partneritetit për integrimin evropian”, ftohet të marrin pjesë lirisht përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, të shoqatave të punëmarrësve, të botës akademike, të mediave dhe grupeve të interesit, duke shprehur interesin e tyre për të bërë anëtarë të “Tryezës së Diskutimit Statistikat” për kapitullin 18-të “Statistikat”.

Do të vlerësonim shprehjen e interesit Tuaj brenda datës 22 Gusht, 2022 duke dërguar një letër interesi dhe CV-në tuaj ku tregoni ekspertizën apo interesin tuaj për të qënë pjesë e tryezës për kapitullin 18 “Statistikat” në adresën ysimoni@instat.gov.al.

INSTAT do të shqyrtojë aplikimet e dorëzuara ku më pas do të bëjë dhe njoftimet përkatëse individualisht. Bashkëngjitur ftesës ndodhen baza përkatëse ligjore ku vepron Instituti i Statistikave, të cilën mund ta gjeni edhe në këtë link <http://instat.gov.al/al/rreth-nesh/legjislacioni/> Ndërkohë, për më tepër informacion në lidhje me veprimtarinë e INSTAT, lutemi të konsultoheni me faqen zyrtare të Institutit të Statistikave <http://instat.gov.al/al/rreth-nesh/ne-jemi-instat/>.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Faks: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al